

Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.205/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.205/2022 të datës 04.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

me adresë

kundër Agjencisë

Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike “kerkese nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.04.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.205/2021 e datës 04.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në pozitën Zyrtar për Çështje ekonomike, në Drejtorin Koordinator të APK-së në Gjilan, me datën 24.01.2022 ka parashtruar kërkesë për identifikimin mbi Mbrojtjen e Sinjalizimit që ndërliidhen me Asistentin administrativ në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Me datën 25.01.2022 përmes e-mailit zyrtar i është refuzuar kërkesa.



Ankuesi kundër refuzimit të kërkesës të datës 24.01.2022 nga Agjencia Pyjore e Kosovës, me datën 04.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1164/2022 përmes e-mailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Më datë 17.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Pyjore të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.03.2022 me numër protokolli 1164/2022 e parashtruar nga ankuesi përmes postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-mail zyrtar i datës 04.03.2022; Vendimi me nr.1186/2021 i datës 14.01.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 13.03.2020 me numër protokolli 1241; Kërkesë e datës 24.01.2022 me numër protokolli 274; Deklaratë e datës 01.08.2019 lidhur me kërcnimin nga asistenti administrativ; Deklaratë e datës 18.10.2019; Njoftim i datës 18.06.2019; Deklaratë lidhur me parregullsitë e evidencës në punë; Deklaratë e datës 13.12.2011; Deklaratë e datës 05.07.2019 lidhur me formularin e evidencës së ardhje -vajtjes në punë; Vërejtje e datës 04.07.2011; Njoftim i datës 04.07.2019 lidhur me formularin për ardhje vajtje nga puna; Email zyrtar i datës 18.10.2019; Shkresë për informim i datës 14.02.2020; Deklaratë e datës 05.07.2019; Kërkesë e muajit janar 2022; E-mail zyrtar i datës 01.03.2022; E-mail zyrtar i datës 25.01.2022; Përgjigje në ankesë e datës 17.03.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 1429/2022 bashkë me shkresat e lëndës; E-mail zyrtar i datës 14.03.2022; Akt emërimi i datës 31.01.2012 për Kërkesë e datës 24.01.2022; Deklaratë e datës 04.02.2019; shkresë për informim e datës 13.12.2021; Kërkesë e datës 24.01.2022 me numër protokolli 276; shkresë për informim e datës 21.02.2020 dhe kërkesë e datës 24.03.2011;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marr parasysh pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon të nxirret vendim për shqiptimin e masave disiplinore ndaj shkelësit të pretenduar sipas ankuesit. Në përgjigjen e dhënë të datës 25.01.2022 nga organi i punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës lidhur me kërkesën e datës 24.01.2022 thuhet se kërkesa e ankuesit është e pabazuar dhe në



kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 dhe 1.2 dhe neni 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar që në ankesën e parashtruar nga ankuesi nuk është konstatuar ndonjë shkelje e konstatuar nga organet kompetente që ka lidhje me interesin e përgjithshëm publik si rrjedhojë e kësaj, ankuesit nuk i janë shkelur asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se: *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji.*, siç përcaktohet me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.205/2022, datë 15.04.2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHC-së.

